



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.2 dhe 64 të Ligjit Nr. 03/L-051 mbi Aviacionin Civil,

Duke marrë parasysh se Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është i autorizuar të mbrojë sigurinë e aviacionit në Republikën e Kosovës,

Duke njohur nevojën për vendosjen e një Zone Mbrotjtëse të Aeroportit në përputhje me standardet e Kapitullit 4, të Aneksit 14, të Konventës së Çikagos,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 5/2010 MBI ZONAT MBROJTËSE TË AEROPORTIT

Neni 1 Aplikueshmëria

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha subjektet juridike dhe personat individual të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ngrisin një ndërtesë në afërsi të një aeroporti dhe për të gjitha institucionet që sipas nenit 34 të Ligjit nr. 2004/15 janë përgjegjës për lëshimin e të gjitha lejeve të ndërtimit të listuara në të, dhe për të gjithë operatorët e aeroporteve të certifikuara në Republikën e Kosovës.

Neni 2 Definicionet dhe Interpretimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje përdoren termet vijuese:

"Aerodrom" nënkupton një fushë të caktuar në tokë (duke përfshirë çfarëdo ndërtesë, instalim dhe pajisje) që mëton të shfrytëzohet tërësisht apo pjesërisht për aterrim, nisje dhe lëvizje sipërfaqësore të avionëve.

"Aeroport" nënkupton fushë aterrimi e cila shfrytëzohet rregullisht nga avionët për marrjen ose zbritjen e udhëtarëve ose të ngarkesave.

"Zona mbrojtëse e aerodromit" nënkupton gjithë aerodromin dhe hapësirat në tokë ose ujë jashtë kufijve të tij, ku lartësia e ndërtimeve është e kufizuar.

"Operator i Aerodromit" nënkupton:

a) çdo person fizik i cili është angazhuar ose i cili shërben në cilësinë e drejtorit ose menaxherit të një aeroporti, aerodromi, fushe ajrore ose një njësie për shërbimin e trafikut ajror, i cili ofron dhe mirëmbanë aerodromin dhe/ose pajisjet për navigim ajror për veprimtarinë e avionëve të transportit publik;

b) çdo person fizik përgjegjës për inspektimin, mirëmbajtjen, riparimin ose riparimin e përgjithshëm të një aerodromi, si dhe çdo individ përgjegjës për inspektimin, mirëmbajtjen, riparimin ose riparimin e përgjithshëm të objekteve të njësisë për shërbimin e navigimit ajror, pajisjeve për radio navigim si dhe pajisjeve dhe aparaturavetë tjera.

“AAC” nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës.

“Aerodrom i certifikuar” nënkupton një aerodrom, operatorit të së cilit i është dhënë një certifikatë aerodromi.

“Ndërtim” nënkupton ngritja, instalimi, zëvendësimi, renovimi, zgjerimi, modifikimi, konvertimi apo demolimi i një konstruksioni ndërtimor, duke përjashtuar punët për mirëmbajtjen e ndërtesave ekzistuese.

“Ndërtuesi” nënkupton çdo person juridik apo fizik që ka treguar interesim të ndërtojë apo ka aplikuar për leje ndërtimi.

“Pajisje Elektronike” nënkupton pajisjet jo-vizuale apo instrumentale që shfrytëzohen në aerodrom për navigacionin ajror.

“Ministria/itë” nënkupton Ministria apo Ministrinë relevante të cilat janë përgjegjëse bashkërisht apo veçanërisht për të lëshuar leje ndërtimi në përputhshmëri me Ligjin Nr. 2004/15 për Ndërtim.

“Komunat” nënkupton komunat që përfshijnë brenda kufijve të tyre sipërfaqësorë një aerodrom apo Zonat Mbrojtëse të tij.

“Pengesë” në lidhje me aerodromin nënkupton të gjitha objektet fikse (qofshin ato të përkohshme apo të përhershme), apo pjesët e tyre, që janë të vendosura në hapësira që mëtojnë të shfrytëzohen për lëvizjen e avionëve në sipërfaqe apo që shtrihen mbi një sipërfaqe të caktuar që ka për qëllim të mbrojë avionin gjatë fluturimit.

“Sipërfaqet me pengesa të kufizuara (SPK)” nënkupton një seri sipërfaqesh që përcaktojnë volumin e hapësirës ajrore në dhe përreth aerodromit që duhet të mbahet pa pengesa për të mundësuar operimet e sigurta të avionëve dhe për të parandaluar ndërtimin e objekteve në zonat përreth aerodromit, që do të ishin pengesa për funksionalitetin e aerodromit.

“Standardet” nënkupton referencën në Standardet për Kufizimin e Pengesave dhe Largimi i tyre si janë të cekura në Kapitullin 4 të Aneksit 14, në Ligjin Nr. 03/L051 për Aviacionin Civil, dhe në këtë Rregullore.

“Aneksi 14” nënkupton aneksin e “Aerodromeve: volumni 1” sipas Konventës së Çikagos, verzioni i fundit në fuqi.

“Harta mbrojtëse” nënkupton një hartë të definuar me ngjyra, e cila i pershkruan Zonat Mbrojtëse të Aeroportit bazuar në kufizimet e lartësisë së ndërtimeve në sipërfaqe të ndryshme përreth aeroportit.

“Pajisje vizuale” nënkupton pajisjet në aerodrom që në mënyrë vizuale e ndihmojnë navigacionin ajror në aerodrom.

“Trajektoret e fluturimit vizuel” apo fluturimet VFR nënkupton fluturimin e udhëhequr sipas rregullave të fluturimit vizuel.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

3.1 Të gjitha aerodromet e certifikuara duhet të kenë Zona Mbrojtëse në të cilat aktivitetet e ndërtimit mund të kufizohen me qëllim të mos rrezikimit të operimeve të fluturimeve nga cilado pengesë.

3.2 Operatorët e aerodromit duhet të definojnë Zonën Mbrojtëse të Aeroportit të aerodromit në të cilin operojnë në përputhje me standardet e Aneksit 14 të Konventës së Çikagos. Këto zona duhet të skicohen në një Hartë Sigurie e cila duhet të pranohet dhe të aprovohet nga AAC dhe e cila duhet të vihet në dispozicion të Ministrisë dhe Komunave përkatëse.

Neni 4

Aplikacionet për leje ndërtimi

4.1 Të gjitha aplikacionet për leje ndërtimi për secilin ndërtim që ndodhet brenda territorit të definuar të Zonës Mbrojtëse të një aerodromi, e cila i adresohet Ministrisë përkatëse dhe/apo Komunës/ave duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak për përmbushje të dispozitave të paragrafit 3.

4.2 Ministria dhe Komunitat duhet që brenda afatit të arsyeshëm, të dërgojnë aplikacionin për leje ndërtimi tek operatori i aerodromit së bashku me të gjitha informacionet e duhura të bashkangjitura me të.

4.3 Operatori i aerodromit duhet të vlerësojë një aplikacion për leje ndërtimi, i cili hyn brenda kornizës së paragrafit 1, lidhur me kriteret në vijim:

- a) Sipërfaqet e ndalimit të pengesave të cilat mbrojnë Rrugët Instrumentale dhe Vizuale të Fluturimit.
- b) Efektet në pajisjet ndihmëse elektronike dhe vizuale për navigacion ajror.
- c) Mundësisë për tërheqje të pranisë së zogjve.

4.4 Operatori i aerodromit duhet brenda 5 ditëve pune, pas marrjes së aplikacionit, të shqyrtoj dhe të jap vlerësimin final të arsyetuar substancialisht tek AAC, duke theksuar ndonjërin nga këto gjetje:

- a) Pa vërejtje lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3;
- b) Pa vërejtje, por me disa kushte të theksuara në mënyrë të duhur;
- c) Me vërejtje, lidhur me ndonjë pikë të paragrafit 3.

4.5 Operatori i aerodromit, mundet përjashtimisht dhe në bazë të ndërlikueshmërisë së çështjes të zgjasë afatin e referuar në paragrafin 4 edhe për pesë ditë tjera, me kusht që paraprakisht të marrë pëlqimin nga Ministria përkatëse ose Komunat e involvuara.

4.6 Varësisht nga vlerësimi paraprak i realizuar nga operatori i aerodromit, AAC do të lëshojë vendim përkatës në lidhje me përmbushjen e dispozitave të paragrafit 3 të një aplikacioni për leje ndërtimi.

4.7 Pavarësisht nga pushteti i dhënë Ministrisë dhe Komunave dhe ushtrimit të kompetencave të tyre në bazë të ligjit të aplikueshëm, këto të fundit duhet të marrin në konsideratë gjetjen në një vlerësim të aprovuar nga AAC, në rastet kur marrin vendim lidhur me një aplikacion për leje ndërtimi i cili hyn brenda kornizës së paragrafit 1.

Article 5
Monitorimi i përmbushjes

Të gjithë operatorët e aerodromeve, duhet që rregullisht të monitorojnë dhe regjistrojnë të gjitha ndërtimet brenda kufijve të definuar të Zonës Mbrojtëse, në raport me përmbushjen e dispozitave të kësaj rregulloreje dhe të raportojnë rezultatet tek AAC.

Article 6
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 20 tetor 2010.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm